Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
ismail rushiti	**14.11.2023**	**20.11.2023**	**2023/0891**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.11.2023, OE “" AS Tech " SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0891, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “KIGA " SH.P.K.”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me klima per objektet e PK-se” me nr. të prokurimit: "214-23-6032-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 58,500.00 €**.**

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i OSHP - së, më Nr. 2023/0614 i dates 06.10.2023

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

-Neni 7 i LPP: Barazia në trajtim jo diskriminimi

-Neni 59 i LPP: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

-Neni 60 i LPP: Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 29 -Variantet e specifikimeve teknike

Parashtrojme kete kerkese per rishqyritm kunder Vendimit te AK-se te dates 23.10.2023.

Pretendimi 1: AK ne procesin e rivleresimit e shperblen perseri OE e njejte Kiga, edhe pse edhe ne Vendimin e pare te AK-se dhe ankesen e dorezuar ne OSHP per ate vendim ky OE ishte i papergjegjshem. Pretendimi yne lidhur me oferten e OE Kiga ishte qe ka ofertuar me dy modele ndonese nuk lejohet me ligj nje gje e till. Ne procesin e rivleresimit ju keni kerkuar sqarime qe OE te specifikoj brendin qe oferton, dhe specifikat e tij , por OE ka sjell nje dokument jo te pranueshem. OE ne pergjigje te letres standarde nuk ka dhene asnje deklarate por vetem ka dorezuar nje dokument nga Distributori per Kosove i nje brendi Rimida qe ai e ka dhene per OE Kiga, por qe askund nuk ceket emri i projektit ne fjale apo numri i prokurimit. Ky dokument nuk mund te jete aspak i pranueshem sepse nuk eshte i leshuar nga OE te cilit i eshte bere kerkesa permes letres standarde. Nuk shkruan askund Deklarate qe OE te deklaron per modelin qe oferton, por eshte thjeshte nje dokument i leshuar nga nje pale e trete per palen e dyte, qe ne kete rast eshte OE Kiga. Perfundimisht OE nuk ju ka pergjigjur AK-se siq AK e ka parashtruar kerkesen dhe rrjedhimisht oferta e tij eshte e papergjegjshme sepse OE nuk ak dhen asnje Deklarate se deklarohet me vule dhe nenshrim te tij per modelin qe oferton.

Ndonese perseri e shohim kontestuese mundesine qe AK i ka dhen OE per te zgjedhur modelin, kur ligji skund nuk e jep nje mundesi te till.

OE ne oferte te tij ka ofertuar me variante dhe kjo nuk eshte e lejuar me ligj te prokurimit publik, Neni 29 -Variantet e specifikimeve teknike- 3. Autoritetet kontraktuese që autorizojnë variantet duhet të deklarojnë në dosjen e tenderit kërkesat minimale për tu plotësuar nga variantet dhe ndonjë kërkesë specifike për prezantimin e tyre.

AK askund ne dosje nuk e ka specifikuar se variantet pranohen, dhe as ne proces te vleresimit nuk eshte dashur te trajohet mundesia e sqarimeve sepse OE brenda ofertes ka ofertuar me dy modele, ne foto te katallogut ka nje model tjeter ndersa me poshte katallogt tek specifikat e klimes perkatese eshte nje model tjeter.

Kjo qeshtje eshte trajtuar shume mire ne ligj te prokurimit.

Pretendimi 2 - Ne qasjen qe e kemi pasur ne oferte nuk kemi deshmi se OE i ka dorezuar Vertetimat tatimor apo te gjykates, prandaj ne kerkese per rishqyrtim kemi kerkuar qe AK te deshmoj se OE i ka sjell ato para Vendimit te AK-se, AK ne pergjigje te Kerkeses per rishqyrtim nuk ka dhen pergjigje per kete pike

Rredhimisht Kerkesa jone per rishqyrtim nuk eshte trajtuar ne kete pike, pra ne nuk kemi pasur qasje te teresishme te ofertes se OE te rekomanduar, Ak nuk e ka respektuar ne teresi kerkesen per qasje siq e lejon edhe ligji.

Pretendimi 3: AK nuk i ka trajtuar njesoj OE, nga OE Kiga ka kerkuar sqarime ndersa nuk ka kerkuar sqarime per oferten tone, perkatesishte per specifikat tona. Konsiderojme se AK ka bere shkelje te LPP-se duke mos i trajtuar barabarte OE. Perfundimisht kerkojme kthim te lendes ne rivleresim dhe shperblim me kontrate te ofertes tone As Tech SHPK.

Kerkojme nga OSHP shqyrtim te 3 pretendimeve tona, Kthim te lendes ne rivleresim dhe shperblim te ofertes tone me kontrate.

KRITERET PËR VLERËSIM

Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

LISTA E PLOTË STANDARDE E RADHITJES SË TENDERËVE SIPAS KRITERIT TË DHËNIES

Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te lire

Sipas Nenit 60.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Kjo listë duhet të largohet nga raporti, në qoftë se kriter për dhënien e kontratës është përcaktuar "Tenderi përgjegjës ekonomikisht më i favorshëm".

Radhë	Lënda / grupi: Furnizim me klima për objektet e PK-së	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	" KIGA " SH.P.K., 810051946	48,880.00

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr:	Grupi:		
1	Furnizim me klima për objektet e PK-së		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	" KIGA " SH.P.K., 810051946	12000	Sllatine e Madhe

DEKLARATË

Komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit, vlerësimit, të ofertave për këtë aktivitet i prokurimit, konstatojmë se komisioni vlerësues rekomandon si ne vijim: t'i jepet kompanisë " KIGA " SH.P.K., i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në dosje të tenderit

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE Ankues "AS Tech " SH.P.K, sipas Vendimit të OSHP-së Nr. 2023/0614 i datës 06.10.2023 rezulton i papërgjegjshëm, prandaj mund të konsiderohet si palë pa interes juridiko material, konform nenit 4, paragrafi 1.26 i LPP-së.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i PSH Nr. 2023/0614 i dates 06.10.2023

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" AS Tech " SH.P.K.**

<u>Sqarim për Panelin Shqyrtues</u>:Autoriteti Kontraktues POLICIA E KOSOVËS, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me klima për objektet e PK-së", me numër të prokurimit: 214-23-6032-1-2-1,procedurë e hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 58,500.00 €.

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë me datën 23.06.2023, Ndërsa AK me datë 04.08.2023 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së.
Me datë 08.08.2023, OE- " AS Tech " SH.P.K., ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, kunder vendimit te AK-se.

Ndërsa, AK me datë 14.08.2023 ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht kundër këtij Vendimi të AK-së, me datë 24.08.2023 OE- " AS Tech " SH.P.K., ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit nr. 2023/0614,dhe në pajtim me nenin 114 të LPP-së, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues dhe për të njëjtat, me datë 11.09.2023, Eksperti shqyrtues i prokurimit ka dorëzuar Raportin e Ekspertizës me nr. **2023/0614**, bazuar në të gjeturat gjatë shqyrtimit dhe administrimit të shkresave të lëndës, *të paraqituara në këtë raport,* meqenëse ka pasur mospërputhje dhe paqartësi ndërmjet "Modelit TCL me kodin **TAC-12CHSA/XA73I"**, dhe "Modelit TCL me kodin **TAC-12CHSD/XA73I**", gjithashtu fakti se gjatë kërkimeve në internet paraqiten specifikime të ndryshme sa i përket këtij modeli**,** andaj për ta qartësuar më mirë këtë situatë, lidhur me katalogun e ofruar nga OE i rekomanduar për kontrate, se a është në përputhje me specifikimet teknike te Aneksit 1 të dosjes së tenderit, AK të kërkoi sqarim shtesë sipas nenit 59.2 dhe nenit 72 të LPP-se.

Pra, *me qëllim të vleresimit të tenderit në përputhje me dispozitat e ligjit dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik,* i propozon Autoriteti Kontraktues -*Policia e Kosovës,* të Anuloi Njoftimin mbi Vendimin e AK-së për këtë aktivitet të prokurimit dhe lënda të kthehet në Ri-Vlerësim, si dhe gjatë ri-vlerësimit lidhur me katalogun e ofruar nga OE i rekomanduar për kontrate, se a është në përputhje me specifikimet teknike te Aneksit 1 të dosjes së tenderit*, AK të kërkon* sqarime shtesë ndaj OE te rekomanduar per kontratë sipas nenit 59.2 dhe nenit 72 të LPP-së.

Si rrjedhojë, bazuar në të gjeturat e paraqitura në raportin e ekspertizes me Nr. 2023/0614, Eksperti shqyrtues i prokurimit i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Praretendimet ankimore të OE ankues " AS Tech " SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me klima për objektet e PK-së, me numër të prokurimit: 214-23-6032-1-2-1", janë shqyrtuar nga Paneli Shqyrtues, si rezultat lidhur me këtë çështje **PSH ka nxjerrë Vendim me Nr. 2023/0614 të datës 06.10.2023.**

Sipas Vendimit të PSH me Nr. 2023/0614 të datës 06.10.2023, bazuar në shkresat e lëndës dhe dëshmitë e dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, Autoriteti Kontraktues POLICIA E KOSOVËS,ka kthyer lëndën në Ri-vlerësim, si dhe me datë 12.10.2023 përmes

Letrës Standarde të kërkesës për sqarimet e tenderëve, në pajtim me nenin 59.2 dhe nenin 72 të LPP-së ka kërkuar sqarime nga OE “KIGA SHPK” i rekomanduar për kontratë.

Lidhur me këtë, AK ka kërkuar sqarime si në vijim:

“Definini modelin e ofruar saktë duke shkruar kodin e modelit te ofruar,

Te na ofroni sqarime ne idhje me gazin qe e përdor ky model i klimës,

Klasën e energjis elektrike”.

<u>Provë:</u>

B47- Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit

12.10.2023, Prishtinë

POLICIA E KOSOVES, Rr "Luan Haradinaj"- nr. 99 ndërtesa e re e Administratës te Policisë, kati II, zyra e Prokurimit nr. 31, Prishtinë, Kosovë

Operatori Ekonomik: **KIGA " SH.P.K.,**

Nr i prokurimit	214-23-6032-1-2-1
Nr i brendshëm	214/23/088/121

Titulli: Furnizim me klima për objektet e PK-së Ri-vlerësim

I/e nderuar(a)

Falënderoni që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin

Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç cilësohet në vazhdim "LPP". Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit si juaj si në vijim:
Sqarime:

Sipas vendimit te OSHP-se me numër 2023/0614 ju lutem te na jepni sqarime sipas nenit 72 për pikat si ne vijim:

- Definoni modelin e ofruar saktë duke shkruar kodin e modelit te ofruar,
- Te na ofroni sqarime ne lidhje me gazin qe e përdor ky model i klimës,
- Klasën e energjis elektrike

Përgjigjen e juaj sqaruese duhet ta ngarkoni në e-prokurim më së largu 5 ditë nga pranimi i kësaj letre standarde.
Pa përgjigjën nga ana e juaj në pyetjen e lartë shënuar ne afat prej 5 ditëve tenderi i juaj do të refuzohet.

Ju falënderojmë paraprakisht,

Me respekt,
Enver Hyseni

Ndërsa,

OE "KIGA SHPK" i rekomanduar për kontratë, sipas kërkesës së AK-së ka ofruar Deklaratë për sqarimin e katalogut për specifikat e klimës, "**Modeli me kodinTAC-12CHSD/XA73I",** pra katalogu i klimës i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, me pershkrim detal e cila është është konform kërkesave të deosjes së tenderit dhe specifikave teknike te Aneksi 1 i dosjes.

<u>Provë:</u>

Kompania : RIMIDA SH.P.K.
NR i biznesit : 812054188
Adresa : Livagjë, Miladina Stevica, p.n.
NR Kontaktues : +38344160331

Deklaratë

Kompania RIMIDA SH.P.K leshon kete deklaratë me kërkesën e kompanisë KIGA SHPK , deklaratë në lidhje me specifikimin per Klima TCL 12 BTU si në vijimë :

1. Modeli/Kodi TAC-12CHSD/XA73I
2.Lloji i gasit : R 32
3.Klasa e energjise elektrike : A++

Në vazhdim gjeni specifikimin e plotë :

Model		TAC-12CHSD/XA73I
Type		heating pump
Control type		remote controller
Declared cooling capacity	W	3400(1000~3770)
Declared heating capacity	W	3420(1000~3810)
Pdesignc	W	3400
SEER declared	W/W	6.1
Energy Class		A++
EER declared	W/W	3.01
COP declared	W/W	3.71

Pdesignh Average		W	2400
SCOP Average declared		W/W	4.0
Energy Class(Average)			A+
Declare capacity(-10℃)		W	2200
Back up heating capacity(-10℃)		W	200
Pdesignh warmer		W	2600
SCOP Warmer declared		W/W	5.1
Energy Class(Wermer)			A+++
Declare capacity(2℃)		W	2600
Back up heating capacity(2℃)		W	0
Pdesignh colder		W	/
SCOP Colder declared		W/W	/
Energy Class(Colder)			/
Declare capacity(-22℃)		W	/
Back up heating capacity(-22℃)		W	/
Annual energy consumption	Cooling	kwh/a	195
	Average	kwh/a	840
	Warmer	kwh/a	714
Moisture removal		Liters/h	1.2
Indoor sound power(S/H/M/L/Mute)		dB(A)	50/47/43/35/32
Outdoor sound power		dB(A)	60
Indoor sound pressure(S/H/M/L/Mute)		dB(A)	40/37/33/25/22
Outdoor sound pressure		dB(A)	50
Electrical Data			
Power supply			220-240V~/50Hz/1P

Power supply side			Outdoor
Voltage Range		V	165~265
Operating current	Cooling	A	5.8(1.5~9.0)
	Heating	A	4.7(1.5~10.0)
Power consumption	Cooling	W	1130(290~1500)
	Heating	W	922(290~1720)
Refrigerating System			
Refrigerant type/Charge/GWP/CO2 equivalent			R32/0.57kg/675/0.385tonnes
Compressor	Type		Rotary
	Model		KSK103D33UEZC3
	MFG		GMCC
Indoor air circulation Cooling/heating		m^3/h	550/550
Indoor fan type			Cross Flow
Indoor fan speed S/H/M/L/Mute	Cooling	rpm	1250/1150/950/850/700
	Heating	rpm	1250/1150/1000/900/800
	Dry	rpm	850
	Sleep	rpm	/
Outdoor fan type			Propeller fan
Outdoor air circulation		m3/h	1900
Outdoor fan speed(S/H/M/L/Mute)		rpm	Cooling:850/810/730/620/550 Heating:850/810/730/620/450
Connections			
Connecting Wiring	Core x Size		4×0.75mm²
Expension device			Capilary
Connecting Pipe	Gas	Inches	3/8"
	Liquid	Inches	1/4"
Others			

Application area		m²	14~22
Max. refrigerant pipe length		m	25
Max. difference in level		m	10
Operation temperature range		℃	16-31
Ambient temperature range	Outdoor	℃	Cooling:-15-53/Heating:-20-30
	Indoor	℃	Cooling:17-32/Heating:0-30
Net dimensions (W x H x D)	Indoor	mm	777×250×201
	Outdoor	mm	777×498×290
Net weight	Indoor	kg	8
	Outdoor	kg	24
Packing dimensions	Indoor	mm	840×315×260 (HC/LC/JC/KE/JE/KC/KF/LE/XA51/XA71/XA81/XA82/XAA1) 850×320×275 (JA/IA/HD/HA/KD/DW1/XA11/XA21/XA31/XA61/XAC1/XAB1/DWE/LF/IF/XA41/XA91)
(W x H x D) w/o pipe	Outdoor	mm	818×520×325
w/i pipe	Outdoor	mm	818×520×325(4m and below) 838×540×338(5m pipe)
Gross weight	Indoor	kg	10.5
	Outdoor	kg	26(w/o pipe) 27(w/i pipe)
Loading Capacity w/o pipe	20'/40'GQ/40' HQ		//310
Loading Capacity w/i pipe	20'/40'GQ/40' HQ		//310(4m and below) //278(5m pipe)

ME Respekt RIMIDA SHP..K

Eksperti shqyrtues sqaron se, pas Ri-vlerësimit të ofertave, AK me datë 23.10.2023 ka nxjerr njoftimin mbi vendimin e AK-së, duke rekomanduar për kontratë OE "KIGA SHPK", Ndërsa, OE-" AS Tech " SH.P.K, me datë 30.30.2023 kundër vendimit të AK-së ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së,ndërsa, AK me datë 31.10.2023 ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, rrjedhimisht kundër këtij Vendimi të AK-së, me datë 10.11.2023 OE- " AS Tech " SH.P.K., ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së.

Sa i përket pretendimit ankimor Nr.2 të OE ankues ndaj OE të rekomanduar për kontratë, lidhur me "Vertetimet tatimor apo te gjykates", Eksperti shqyrtues sqaron se, bazuar në shkresat e lëndës dhe dëshmitë e dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim,OE i rekomanduar për kontratë sipas kërkesës së AK-së ka dorëzuar Vertetimet lidhur me nenin 65 të LPP-së.

Ndërsa,

Sa i përket pretendimeve ankimore Nr. 1 dhe 3 të OE ankues, të paraqitura në ankesen Nr. 2023/0891 për këtë aktivitet të prokurimit, Eksperti shqyrtues këto pretendime ankimore nuk i ka shqyrtuar për faktin se, të njejtat pretendime ankimore janë shqyrtuar në lëndën me Nr.

2023/0614.

Eksperti shqyrtues, bazuar në sqarimet e lartë cekura, si dhe bazuar në Vendimin e PSH Nr. 2023/0614 i datës 06.10.2023, OE ankues " AS Tech " SH.P.K, për këtë aktivitet të prokurimit rezulton i papërgjegjshëm. Andaj, marrë parasysh ato që u thanë me lartë, si dhe duke marrë parasysh edhe Njoftimin e OSHP-së të datës 09.02.2023 të publikuar në web faqen e OSHP-së, Eksperti shqyrtues, Operatorin Ekonomik ankues për këtë aktivitet të prokurimit e sheh si palë pa interes juridiko material, konform nenit 4, paragrafi 1.26 i LPP-së, i cili përcakton: "*Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar*" .

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" AS Tech " SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

ismail rushiti